

STANDARDET MINIMALE DHE KOMPONENTËT E PROPOZUAR TË KURRIKULAVE

PËR TRAJNIMIN E POLICISË DHE
GJYQËSORIT NË PARANDALIMIN
DHE LUFTËN KUNDËR DHUNËS NDAJ
GRAVE DHE VAJZAVE

ACKNOWLEDGEMENTS

Mbështetje organizative, menaxhuese e projektit dhe rishikimi:

Elmaja Bavčić, Maaïke van Andrichem, Kateryna Hai

Zhvillimi i përmbajtjes:

Stojanka Mirčeva

Hulumtimi:

Maida Čehajić – Čampara, Stojanka Mirčeva, Edlira Shima

Redaktimi :

Elisabeth Duban

Dizajni dhe faqosja:

Nina Kononova

Programi për Çështjet Gjinore, Zyra e Sekretariatit të Përgjithshëm të OSBE-së gjithashtu falënderon kolegët nga operacionet në terren të OSBE-së, që kontribuan në zhvillimin e këtij publikimi me angazhimin dhe komentet e tyre, përkatësisht: Fedra Idzakovic, Biljana Nastovska, Valdete Osmani, Tatjana Stoimenovska, Aleksandra Crvenica dhe Anne-Elisabeth Gautier, si dhe për Bjorn Tore Saltvik dhe Alina Munteanu për mbështetjen dhe bashkëpunim e vazhdueshëm.

LISTA E SHKURTESAVE

CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
OSHC	Organizata e shoqërisë civile
DHF	Dhuna në familje
DHBGJ	Dhuna me bazë gjinore
GREVIO	Grupi i Ekspertëve të Këshillit të Evropës për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
Konventa e Stambollit	Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
M&V	Monitorimi dhe vlerësimi
OSBE	Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë
DHNGV	Dhuna ndaj grave dhe vajzave

HYRJE

Në vitin 2021, Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE) zhvilloi një ushtrim hartëzimi të kurrikulave për trajnimin e policisë dhe gjyqësorit për dhunën ndaj grave dhe vajzave (DHNGV) si pjesë e projektit “WIN për Gratë dhe Burrat: Forcimi i Sigurisë Globale nëpërmjet Inovacionit dhe Rrjetëzimit për Barazinë Gjinore”. Hartëzimi u zhvillua në Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut dhe Serbi. Ai u zhvillua gjithashtu edhe në Kosovë¹. Ushtrimi i hartëzimit, që vëzhgoi kurrikulat ekzistuese të trajnimit për DHNGV-në, kishte për qëllim të identifikonte qasjet premtuese dhe praktikatat e mira, si dhe mësimet e nxjerra dhe të metat lidhur me nivelin që këto aktivitete trajnimi u përmbahen standardeve ndërkombëtare dhe integrojnë qasjen me viktimën në qendër².

Paralelisht me hartëzimin, u vendosën një sërë standardesh minimale si dhe komponentët e kurrikulave të trajnimit për DHGVN-në për policinë dhe gjyqësorin, në mbështetje të hartuesve të politikave dhe institucioneve trajnuese që hartojnë dhe ofrojnë trajnime për dhunën ndaj grave dhe vajzave. Standardet minimale të propozuara reflektojnë standardet e përcaktuara nga Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit). Standardet gjithashtu mbështeten në raportet shpjeguese të Këshillit të Evropës mbi

Konventën e Stambollit si dhe propozimet dhe sugjerimet në raportet e vlerësimit bazë³ të Grupit të Ekspertëve të Këshillit të Evropës për Veprimin kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO), organi që monitoron zbatimin e Konventës së Stambollit. Gjatë zhvillimit të standardeve minimale të propozuara, u morën parasysh detyrimet e përcaktuara në Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), në lidhje me udhëzimet që përmbajnë Rekomandimet e Përgjithshme të mëposhtme të Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave: Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 19 (1992) mbi dhunën ndaj grave; Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 33 (2015) për qasjen e grave në drejtësi; dhe Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 35 (2017) për dhunën me bazë gjinore ndaj grave, duke përditësuar Rekomandimin e Përgjithshëm Nr. 19.

Burime të tjera informacioni që u konsultuan përfshijnë anketën e drejtuar nga OSBE-ja për dhunën ndaj grave⁴, dhe materialin përkatës nga organizatat e tjera ndërkombëtare, përfshi UN Women dhe Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin.

¹ Të gjitha referencat për Kosovën, qoftë për sa i përket territorit, institucioneve ose popullsisë së saj, në këtë kontekst duhet të kuptohen në përputhje të plotë me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244.

² Meqenëse raporti fokusohet në sektorin e drejtësisë, termi “viktimë” përdoret për të pasqyruar terminologjinë e përdorur në sistemin e së drejtës penale. Megjithatë, sa herë që përmendet mbështetja në shumë sektorë, ky raport përdor termin “i/e mbijetuar”.

³ Të gjitha Shtetet Palë që u përfshinë në ushtrimin e hartëzimit janë palë në Konventën e Stambollit dhe kanë dorëzuar raportet e tyre (të para) bazë në GREVIO që janë vlerësuar nga GREVIO. Raporti i vlerësimit bazë i GREVIO-s për Maqedoninë e Veriut pritet të botohet në vitin 2023.

⁴ Rezultatet e anketës së drejtuar nga OSBE për dhunën ndaj grave në vitin 2018 mund t'i gjeni në: <https://www.osce.org/VAWSurvey/publications>.

Pse duhen standardet minimale për trajnimin profesional për DHNGV-në?

Neni 15 i Konventës së Stambollit njih rëndësinë e trajnimit profesional dhe kërkon që qeveritë dhe institucionet publike të ofrojnë ose të forcojnë trajnimin e duhur për profesionistët, përfshi profesionistët që punojnë në sistemet e drejtësisë penale.

Standardet minimale të propozuara mbulojnë qasjen e përgjithshme për zhvillimin e programeve të trajnimit, përmbajtjen e trajnimit, kompetencat e trajnuesve, financimin, monitorimin dhe vlerësimin.

KONVENTA E STAMBOLLIT, NENI 15 - TRAJNIMI I PROFESIONISTËVE

- 1. Palët sigurojnë ose forcojnë trajnimin e duhur për profesionistët përkatës që merren me viktimat ose autorët e të gjitha akteve të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente, mbi parandalimin dhe zbulimin e një shkeljeje të tillë, barazinë midis burrave dhe grave, nevojat dhe të drejtat e viktimave, si dhe mënyrën e parandalimit të viktimizimit dytësor.**
- 2. Palët inkurajojnë që trajnimi i përmendur në paragrafin 1 të përfshijë trajnim për bashkëpunimin e bashkërenduar midis shumë agjencive, për të lejuar një trajtim gjithëpërfshirës dhe të duhur të referimeve në rastet e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente.**

→ STANDARDI I KUJDESIT TË DUHUR

Konventa detyron Shtetet Palë të marrin masa aktive **për të parandaluar të gjitha format e DHNGV-së, për të mbrojtur viktimat, për të ndjekur penalisht autorët dhe për të siguruar dëmshpërblim për aktet e dhunës**⁵. Shtetet Palë duhet të sigurojnë që viktimat e dhunës ndaj grave dhe vajzave të merren në mbrojtje maksimale, që të gjitha pretendimet e një dhune të tillë të hetohen plotësisht dhe me efikasitet dhe që autorët të sillen para drejtësisë.

Sipas ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, Shtetet Palë kanë si detyrime negative ashtu dhe detyrime pozitive. Zyrtarët qeveritarë duhet të respektojnë ligjin dhe të mos kryejnë shkelje të të drejtave të njeriut dhe gjithashtu duhet të mbrojnë individët nga shkeljet e kryera nga aktorë jo shtetërorë. Mund të diskutohet nëse detyrimi për të ofruar trajnime profesionale

mund të konceptohet si një mjet me anë të të cilit qeveritë ushtrojnë kujdesin e duhur, duke siguruar që profesionistë të veçantë të kenë kompetencat e nevojshme për të parandaluar dhunën, për të mbrojtur viktimat dhe për të ndjekur penalisht autorët.

Për më tepër, vetë trajnimi duhet të përdoret si një mundësi për të rritur ndërgjegjësimin për detyrimin e Shteteve Palë për të siguruar që autoritetet, zyrtarët, agjentët, institucionet dhe të tjerë që veprojnë në emër të tij, të mos kryejnë akte dhune kundër grave. Përveç kësaj, ndërtimi i kapaciteteve duhet të ndërgjegjësojë profesionistët për detyrimin që kanë për të ushtruar kujdesin e duhur lidhur me aktet që mbulojnë nga lex specialis të kryera nga aktorët jo shtetërorë.

→ INSTITUCIONALIZIMI

Shtetet Palë janë të detyruara **të ofrojnë dhe të venë në dispozicion** trajnimin profesional. Për këtë arsye, institucionalizimi i trajnimit duhet të kuptohet si një **proces gjithëpërfshirës**, i cili përfshin, të paktën, elementët e mëposhtëm:

- Një dizajn i veçantë për kurset e trajnimit që i përgjigjet çështjes së DHNGV-së
- Miratimi i kurseve të tilla nga institucionet trajnuese dhe përfshirja në programet e trajnimit si të detyrueshëm ashtu dhe vullnetar
- Ofrimi i trajnimeve nga trajnues të cilët janë certifikuar posaçërisht lidhur me dhunën kundër grave dhe vajzave
- Miratimi i kërkesave të qarta minimale për të trajnuarit për të marrë certifikata që janë të disponueshme përpara trajnimit dhe
- Monitorimi dhe vlerësimi i trajnimeve rregullisht

Trajnimi gjithëpërfshirës i rregullt dhe afatgjatë që kontribuon në ndryshimin e pikëpamjes dhe qëndrimin të profesionistëve përkatës lidhur me viktimat⁶ mund të arrihet vetëm kur të institucionalizohet trajnimi i duhur për DHNGV-në. Trajnimet e herëpashershme ose ad hoc, të kryera nga organizatat ndërkombëtare si dhe organizatat e grave të shoqërisë civile ose në bashkëpunim të ngushtë me to, mund të jenë shumë efektive, por kjo nuk është pjesë e qasjes së qëndrueshme dhe mund të mos ketë një ndikim afatgjatë.

⁵ Neni 5, Konventa e Stambollit.

⁶ Këshilli i Evropës, Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, Raport Shpjegues 2011, para. 98.

→ KONTEKSTUALIZIMI

Procesi i institucionalizimit të trajnimit të duhur për DHNGV-në duhet të kryhet pasi të kuptohet konteksti specifik lokal, duke përshtatur kurset e trajnimit sipas vendit. Kontekstualizimi i trajnimit për DHNGV-në njeh kontekstin ligjor vendas, që cakton detyrimet dhe procedurat e përshtatshme për trajnuesit dhe nevojën për zbatimin e standardeve ndërkombëtare. Përveç kësaj, trajnimi i kontekstualizuar pranon gjithashtu se reagimi ndaj DHNGV-së kushtëzohet nga vlerat specifike kulturore, tradicionale, pronësore, politike dhe morale në një kontekst dhe kohë të caktuar dhe i trajton ato në mënyrën e duhur. Trajnimi duhet të bazohet në analizën e kontekstit institucional të veçantë dhe qëndrimet mbizotëruese kundrejt dhunës me bazë gjinore dhe barazisë gjinore.

Për shembull, ushtrimi i hartëzimit tregoi se juridiksionet që u studiuan, jo vetëm ndajnë një traditë ligjore, që rrjedh nga historia e tyre në ish-Jugosllavi, por kanë gjithashtu qëndrime sociale të përbashkëta në lidhje me barazinë gjinore, shoqëruar me një kulturë të përhapur të fajësimit të viktimës dhe perceptimin se dhuna e kryer nga burrat ndaj grave është një aspekt i trashëgimisë

→ VLERËSIMI I NEVOJAVE

Idealisht, çdo program trajnimi mund të zhvillohet bazuar në vlerësimet dhe analizat e nevojave të trajnimit. Në veçanti, vlerësimi i nevojave për trajnimin për DHNGV-në duhet të marrë parasysh **qëndrimet kundrejt barazisë gjinore dhe perceptimin e saj, rolet e grave dhe stereotipitë e gjinisë; njohuritë dhe aftësitë e kërkuara nga të trajnuarit potencialë në punën e tyre profesionale; dhe njohuritë paraprake të të trajnuarve dhe ekspozimi ndaj tematikave lidhur me gjininë**. Ka po aq rëndësi që vlerësimi të reflektojë nevojat e atyre që do të bien në kontakt me të trajnuarit dhe në këtë mënyrë do të ndikohen nga rezultatet e trajnimit. Kurdo kur jepet mundësia, vlerësimi i nevojave duhet të përfshijë nevojat dhe perspektivat e një sërë profesionistësh me përvojë në punën me viktimat e DHNGV-së, të cilët ndërveprojnë me policinë dhe gjyqësorin, me organizatat e shoqërisë civile të grave, OSHC-të, me entitete të tjera që ofrojnë shërbime mbështetëse të

së vlerave tradicionale familjare dhe që kjo dhunë mund të justifikohet nëse gratë nuk tregohen të bindura ndaj burrave⁷. Profesionistët e zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit nuk rrojnë jashtë shoqërisë dhe në mungesë të trajnimit dhe politikës institucionale që synojnë të zhdukin paragjykimet dhe stereotipitë gjinore, ata mund t'i përsërisin në jetën e tyre personale. Për këtë arsye, programet e trajnimit që kanë për qëllim të institucionalizojnë një reagim me ndjeshmëri gjinore ndaj dhunës kundër grave, duhet të marrin parasysh kontekstin social specifik në të cilin veprojnë të trajnuarit, përfshi besimet, vlerat dhe stereotipitë e zakonshme.

Me qëllim që standardet ndërkombëtare të zbatohen në nivel kombëtar në mënyrë efektive, është e nevojshme që standarde të tilla të vendosen brenda kontekstit lokal. Trajnimi i duhur për DHNGV-në kërkon përputhjen me standardet ndërkombëtare dhe rajonale, ndërkohë që përballet me sukses me modelet sociale dhe kulturore, paragjykimet dhe njëanshmëritë që përjetësojnë nocionet e inferioritetit të grave dhe stereotipitë për rolin e grave dhe burrave⁸.

specializuara për gratë viktime të dhunës, si dhe me institucione të tjera të angazhuara në parandalimin dhe mbrojtjen.

Anketat e prevalencës, të cilat kryhen rregullisht dhe përfshijnë vlerësimet e përshtypjeve të përfituesve për shërbimet e ofruara lidhur me dhunën me bazë gjinore (DHBGJ), mund të jenë mjete veçanërisht të dobishme gjatë zhvillimit të kurseve të trajnimit.

Përveç pyetësorëve që u jepen atyre që do të trajnohen në të ardhmen, vlerësimet e nevojave mund të përfshijnë intervista dhe diskutime në grup lidhur me një tematikë të caktuar, me profesionistë të tjerë që do të kontribuonin për të kuptuar më mirë nevojat e trajnimit, në mënyrë që ai të hartohet në përputhje me rrethanat. Vlerësimi i nevojave të trajnimit nuk duhet kuptuar si një aktivitet i shkëputur, por si një detyrë shoqëruese që ndërmerret rregullisht (për shembull, një herë në dy vjet) dhe pasqyron kontekstin.

⁷ Shihni për shembull, GREVIO Raportet Vlerësuese Bazë për Serbinë, 2020 (par. 63), Mali i Zi, 2018 (paragrafët 68–70), Shqipëria, 2017 (paragrafët 52–54); dhe OSBE, Anketat e drejtuar nga OSBE rreth dhunës ndaj grave: Raporti kryesor - Mirëqenia dhe siguria e grave (Vienna: OSCE, 2019), f. 24.

⁸ Nenet 12 dhe 14, Konventa e Stambollit; Seksioni C, Komisioni për eliminimin e diskriminimit të grave, Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 33 mbi qasjen e grave në drejtësi.

→ PROGRAMI DHE MATERIALET E VEÇANTA TË TRAJNIMIT PËR DHNGV-në

Ushtrimi i hartëzimit i OSBE-së tregoi se modulet e DHNGV-së shpesh janë futur në kurset e trajnimit me tema të tilla si e drejta penale ose ligji për familjen. Megjithatë, nevojitet një **program trajnimi i veçantë për DHNGV-në** për trajnimin bazë dhe gjatë punës⁹, për të rritur vizibilitetin dhe përparësimin e reagimit nga policia, prokuroria dhe gjykata dhe për të siguruar që dhuna kundër grave të trajtohet si një krim i rëndë. Ekzistenca e një programi të veçantë për DHNGV-në mund të shërbejë për përmirësimin e reagimit ndaj DHNGV-së si dhe për të hartuar **programe trajnimi sistematike dhe të qëndrueshme**.

Një program i veçantë trajnimi për DHNGV-në duhet të përdorë **manuale trajnimi** të cilësisë së lartë **dedikuar kësaj tematike**. Një manual trajnimi, i përshtatur formalisht nga institucioni përkatës i trajnimit, është baza për kryerjen e trajnimeve sistematike dhe të qëndrueshme. Manualë të tillë mund të mbulojnë një sërë temash dhe të shërbejnë si një mjet për ushtrimet e mësuarit ndërveprues dhe studimit të rasteve që mund të kombinohen me trajnime simuluese në vendin e punës (për shembull, aktivitetet e trajnimit që përdorin mjediset aktuale

ku përpunohen rastet e DHNGV-së). Një manual trajnimi është gjithashtu një burim për trajnuesit kur planifikojnë dhe kryejnë seanca të të mësuarit ndërveprues për të rriturit, për profesionistët mbi tema të ndryshme që lidhen me reagimet efektive ndaj DHNGV-së, në varësi të nevojave të pjesëmarrësve në trajnim. OSHC-të e specializuara të grave duhet të ftohen të kontribuojnë në hartimin e manualeve të tilla, zhvillimin e programeve të trajnimit dhe ofrimin e trajnimeve.

Trajnimi duhet të mbështetet dhe të përforcohet nëpërmjet **protokolleve dhe udhëzimeve të qarta që përcaktojnë standardet** që duhet të ndjekë stafi në fushat e tyre përkatëse.¹⁰ Protokolle dhe udhëzime të tilla mund të marrin formën e procedurave standarde vepruese për ligjzbatuesit dhe të përfshijnë praktikën përkatëse gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, opinionet ligjore të gjykatave më të larta vendase ose udhëzimet gjyqësore për një qasje multidisiplinare ndaj dhunës ndaj grave që ofrojnë masa minimale të standardizuara për të gjithë profesionistët dhe pasqyrojnë një interpretim gjinor të formave të DHNGV-së.

→ TRAJNIM I DETYRUAR DHE SISTEMATIK PËR DHUNËN NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE

Trajnimi që sensibilizon profesionistët e policisë dhe të drejtësisë për shkaqet, shfaqjet dhe pasojat e të gjitha formave të DHNGV-së duhet të jetë i detyrueshëm dhe sistematik, brenda kontekstit të institucionit specifik të trajnimit. **Trajnim i detyrueshëm i referohet si trajnimit bazë ashtu edhe atij për të gjithë profesionistët e punësuar. Trajnimi sistematik përfshin trajnim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm dhe kontrollin e duhur** për të siguruar që aftësitë e fituara rishitas të zbatohen në mënyrë të përshtatshme¹¹. Në lidhje me trajnimin që do të mundësojë një reagim efektiv duke zhvilluar dhe forcuar ndjeshmërinë gjinore dhe aftësitë profesionale për t'iu përgjigjur DHNGV-së, është e rëndësishme që shtrirja dhe përmbajtja e trajnimit gjatë punës për

oficerët e zbatimit të ligjit të bazohet në profilet e tyre specifike të punës (që do të thotë se trajnimi duhet të përshtatet me rolet e tyre). Për sa i përket trajnimit gjatë punës për gjyqtarët dhe prokurorët, është një praktikë rajonale që gjyqtarët dhe prokurorët të kenë autonomi në përzgjedhjen e kurseve të trajnimit që ndjekin. Megjithatë, kjo praktikë duhet të rishikohet pa cenuar pavarësinë dhe autonominë e profesionit të gjyqësorit, përfshi edhe organizimin e trajnimeve.

Është po aq e rëndësishme që të zhvillohen trajnime, ose module trajnimi brenda programeve ekzistuese të trajnimit, për profesionistët që ofrojnë mendime ekspertësh për gjykatat në rastet që lidhen me DHNGV-në.

⁹ Trajnimi bazë ose fillestar u ofrohet rekrutëve të rinj ose profesionistëve të sapo punësuar (policia) si dhe kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë. Trajnimi gjatë punës ose i vazhdueshëm, është për edukimin e profesionistëve të sektorit të drejtësisë, të cilët kanë tashmë përvojë pune për të përmirësuar aftësitë e tyre.

¹⁰ Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, Raport Shpjegues 2011, par. 99.

¹¹ Ibid., par. 98–99.

→ BARAZIA GJINORE DHE DHUNA ME BAZË GJINORE NDAJ GRAVE

Arritja e barazisë gjinore është thelbësore për eliminimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave. Vetëm barazia thelbësore midis grave dhe burrave, kur gratë dhe burrat gëzojnë të drejta të barabarta dhe de facto kanë mbrojtje të barabartë përpara ligjit, të njëjtat mundësi dhe vlerësohen dhe respektohen njëllëj si kontribuues në shoqëri, do të çojë në ndryshime të dinamikës dhe qëndrimeve të pushtetit dhe rrjedhimisht, në eliminimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave. Trajnimi model synon **të ndryshojë qëndrimet dhe të eliminojë stereotipitë** jo vetëm në nivel të pjesëmarrësve individualë në trajnim por

edhe brenda institucioneve. Trajnimi që përmirëson të kuptuarit e fenomenit të dhunës me bazë gjinore duhet të nënvizojë se **pabarazia gjinore është motivi parësor i DHNGV-së**. Është gjithashtu e rëndësishme që trajnimi të trajtojë **ndikimin e stereotipive dhe paragjyqimeve gjinore që përjetësojnë dhunën me bazë gjinore**. Programet e trajnimit duhet të trajtojnë stereotipitë dhe paragjyqimet gjinore si shkaqet kryesore të dhunës ndaj grave dhe, në të njëjtën kohë, të sfidojnë dhe shpërbëjnë stereotipitë gjinore që ekzistojnë në shoqëri.

→ QASJA ME BAZË GJINORE NDAJ TË GJITHA FORMAVE TË DHUNËS NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE, PËRFSHI DHUNËN NË FAMILJE

Si rregull, trajnimi duhet të ofrojë njohuri dhe aftësi që ndihmojnë profesionistët për të kuptuar nga **këndvështrimi gjinor, të gjitha format e dhunës ndaj grave**, të cilat duhet t'i zbatojnë gjatë procedurave për mbrojtjen e viktimave, të tilla si vlerësimi i rrezikut, urdhrat e ndalimit emergjent dhe urdhrat e mbrojtjes, kur vendosin për çështjet e vizitës/kujdestarisë për fëmijët dhe kur japin rekomandime. Konventa e Stambollit vendos një detyrim për Shtetet Palë që të trajtojnë **të gjitha format e dhunës ndaj grave** dhe krijon një kuadër ligjor gjithëpërfshirës për të trajtuar shkeljet të rënda të të drejtave të njeriut dhe të grave.

Kjo do të thotë se të gjitha format e DHNGV-së duhet të trajtohen nga një perspektivë "që njeh dinamikën gjinore, ndikimin dhe pasojat e këtyre formave të dhunës dhe që funksionon brenda kornizës së barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut"¹². Kërkesa për një **qasje të integruar të bazuar në të drejtat e njeriut**, synon të integrojë parandalimin,

mbrojtjen dhe ndjekjen penale. Çdo masë e marrë për të mbështetur dhe mbrojtur viktimën duhet të përqendrohet në të drejtat e njeriut dhe sigurinë e viktimës, duke marrë parasysh "marrëdhëniet midis viktimave, autorëve, fëmijëve dhe mjedisit të tyre më të gjerë për të shmangur rrezikun e trajtimit të nevojave të tyre në izolim ose pa marrë parasysh realitetin social"¹³.

Në vitin 2022, Platforma e Mekanizmave të Pavarur të Ekspertëve për Diskriminimin dhe Dhunën ndaj Grave botoi një studim me temë **dimensioni digjital i dhunës ndaj grave**, i cili, inter alia (ndër të tjera), identifikon boshllëqet në ofrimin e trajnimit mbi këtë formë në zhvillim të DHNGV-së për personelin juridik dhe penal¹⁴. Ka lindur nevoja që në trajnimin e policisë dhe gjyqësorit të përfshihet njohja dhe reagimi specifik ndaj dhunës digjitale.

¹² Ibid., par. 115.

¹³ Ibid., par. 116.

¹⁴ (Këshilli i Evropës, "Dimensioni digjital i dhunës ndaj grave siç trajtohet nga shtatë mekanizmat e Platformës EDVAW"), 17 nëntor 2022, f. 27.

→ QASJA ME VIKTIMËN NË QENDËR

Qasja me viktimën në qendër i vendos **nevojat dhe të drejtat** e grave viktimat dhe fëmijëve të tyre në qendër të të gjitha masave. Me qëllim që viktimat të marrin mbështetjen më efektive të mundshme, të drejtat, nevojat dhe siguria e tyre duhet të vihen në krye të të gjitha ndërhyrjeve. Kjo nënkupton ofrimin e mbrojtjes dhe mbështetjes ndërkohë që **viktimat trajtohen me respekt dhe ndjeshmëri si dhe fuqizimin** e tyre për të marrë vendime të informuara që pasqyrojnë më së miri interesat e tyre. Trajnimi duhet të shërbejë për të mbajtur një qëndrim jo diskriminues dhe për të kuptuar se disa rrethana mund t'i bëjnë viktimat të caktuara veçanërisht të cenueshme. Kjo do të thotë që theks i veçantë duhet t'i vihet konceptit të diskriminimit **interseksional**¹⁵. Domethënë, profesionistët duhet të kuptojnë se si rreziqet dhe përvojat e dhunës ndërthuren me një sërë identitetesh të grave dhe vajzave - për shembull, gratë dhe vajzat me aftësi

të kufizuara, ato që jetojnë në zona rurale, gratë e moshuara, vajzat adoleshente, gratë në prostitucion, gratë dhe vajzat që jetojnë me HIV dhe AIDS, gratë dhe vajzat nga pakicat etnike (të tilla si gratë dhe vajzat rome) dhe grupet e pakicave fetare, si dhe gratë dhe vajzat me një status ose identitet ligjor ose ndonjë status tjetër që mund të shtojë rrezikun e dhunës dhe të krijojë pengesa për qasjen në mekanizmat mbrojtës dhe drejtësinë¹⁶. Qasjet me viktimën në qendër u japin **përparësi shqetësimeve të sigurisë në të gjitha vendimmarrjet** gjatë një hetimi, procedurës paraprake, gjatë gjykimit dhe dënimit dhe pas gjykimit, si dhe në të gjitha përballjet me autorin e veprës penale. Trajnimi duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë **eliminimit të qëndrimeve fajësuese ndaj viktimave** ose hedhjes së përgjegjësisë të viktimat për përvojat e tyre të dhunës.

→ QASJA E KOORDINUAR E ORGANIZMAVE TË SHUMTË

Për shkak të natyrës komplekse të dhunës ndaj grave, duke përfshirë dhunën në familje (DHF), trajnimi duhet të përfshijë si temë bashkëpunimin e koordinuar mes shumë organizmave, i cili kërkohet për trajtimin gjithëpërfshirës dhe të duhur të rekomandimeve në rastet e dhunës që mbulon Konventa e Stambollit¹⁷. Trajnimi duhet të përfshijë identifikimin e pikave fillestare për bashkërendimin e referimeve dhe veprimeve vijuese ndërmjet organeve të ndryshme, si brenda ashtu dhe jashtë sistemit të drejtësisë. Koordinimi dhe reagimi i shumë organizmave duhet të bazohen në dokumentacionin

e përshtatshëm të dhunës në fjalë, duke respektuar privatësinë dhe konfidencialitetin e të mbijetuarës dhe me pëlqimin e lirë dhe të informuar të saj. Roli i shërbimeve përkatëse qeveritare, si dhe i OSHC-ve të grave, në ofrimin e shërbimeve për të mbijetuarat duhet të trajtohet në aktivitetet e trajnimit në mënyrë që profesionistët e policisë dhe drejtësisë të ndërgjegjësohen se ku t'i drejtojnë të mbijetuarat. Trajnimi që ofrohet për shumë organizma duhet të përfshijë tema mbi bashkërendimin e masave të sigurisë, si dhe shërbime të koordinuara të mbrojtjes dhe mbështetjes.

¹⁵ Meghan Campbell, "CEDAW dhe identitetet interseksionale të grave: Një qasje e re ndaj diskriminimit interseksional", Dokument Pune i Universitetit të Oksfordit Vol. 2, Nr. 3, shkurt 2016. Gjetet në <https://globalnaps.org/wp-content/uploads/2018/08/cedaw-and-women-s-intersecting-identities-a-pioneering-approach-to-intersectional-discrimination.pdf> (aksesuar 17 janar 2022).

¹⁶ Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, Raport Shpjegues par. 87.

¹⁷ Neni 15, par. 2, Konventa e Stambollit

→ EFEKTI I DHUNËS TE FËMIJËT SI VIKTIMA DHE DËSHMITARË

Së paku, trajnimi duhet të trajtojë **nevojat dhe të drejtat e fëmijëve**, pavarësisht nëse fëmija është viktimë e drejtpërdrejtë ose dëshmitar i DHNGV-së, përfshi dhunën në familje. Në disa raste, dhuna drejtohet si ndaj grave ashtu edhe ndaj fëmijëve. Në raste të tjera, fëmijët nuk janë vetë në shënjestër, por janë dëshmitarë të dhunës ndaj nënave të tyre, të vetes së tyre ose anëtarëve të tjerë të familjes. Duhet t'i kushtohet vëmendja e duhur **technikave**

të intervistimit, njohjes së shenjave të traumës dhe shmangies së viktimizimit dytësor të fëmijëve. Rekomandohet trajnim i posaçëm për procesin e përcaktimit të të drejtave të kujdestarisë dhe vizitave të fëmijëve që merr parasysh incidentet e DHNGV-së. Një trajnim i tillë duhet të theksojë gjithashtu se të drejtat e prindërve për vizita dhe kujdestari nuk duhet të rrezikojnë të drejtat¹⁸ dhe sigurinë e viktimës ose të fëmijëve të tyre.¹⁹

→ QASJA E PËRFSHIRJES SË AFTËSIVE TË KUFIZUARA

Forma të caktuara të dhunës, shfrytëzimit ose abuzimit mund të konsiderohen mizore, çnjerëzore, trajtime ose dënime degraduese dhe shkelje e traktateve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.²⁰ Ndër ato që prekin veçanërisht gratë me aftësi të kufizuara janë shtatzënia ose sterilizimi i detyruar, shtrëngues ose ndryshe i pavullnetshëm, si dhe çdo procedurë ose ndërhyrje tjetër mjekësore e kryer pa pëlqimin e lirë dhe të informuar, përfshirë ato që lidhen me kontraktivët dhe abortin; praktikat kirurgjikale invazive dhe të pakthyeshme, duke përfshirë gjymtimin gjenital të femrës ose operacion ose trajtim i kryer te fëmijët interseks pa pëlqimin e tyre të informuar. Dhuna seksuale ndaj grave me aftësi të kufizuara përfshin përdhunimin. Abuzimi seksual ndodh në lloj lloj skenarësh brenda institucioneve të shtetërore dhe jo shtetërore të Shteteve Palë si dhe brenda familjes dhe komunitetit. Disa gra me aftësi të kufizuara, veçanërisht gratë e shurdhra apo të shurdhra e të verbra, si dhe gratë me aftësi të kufizuara intelektuale, mund të jenë në rrezik të mëtejshëm të dhunës dhe abuzimit për shkak të izolimit dhe varësisë së tyre ose për shkak të shtypjes.²¹

Trajnimi për DHNGV-në dhe dhunën në familje duhet të rrisë kapacitetet e profesionistëve përkatës për të përvetësuar **qasjen e përfshirjes së aftësive të kufizuara**. Kjo nënkupton sigurimin e mbrojtjes për gratë me aftësi të kufizuara që i kanë mbijetuar dhunës. Megjithatë, trajnimi nuk duhet kufizuar vetëm në konceptin e përfshirjes së aftësive të kufizuara, por ai gjithashtu duhet të përqendrohet edhe në zhvillimin e aftësive dhe në përvojën praktike. Pjesëmarrësit në trajnim duhet të fitojnë njohuritë dhe aftësitë për të aplikuar mekanizma dhe teknika specifike me qëllim që viktimat me aftësi të kufizuara të kenë qasje në të gjitha proceset e sistemit të drejtësisë. Gjatë një trajnimi të tillë, trajnuesit duhet të ftojnë specialistë me aftësi të kufizuara ose që kanë njohuri të thella në aftësitë e kufizuara ose të ndërthurjes së DHNGV-së dhe aftësive të kufizuara. Përfshirja e kësaj perspektive rrit efektivitetin e trajnimit dhe kontribuon në ndryshimin e dinamikës së forcës që përndryshe mund të kontribuonte në stigmatizim dhe diskriminim.

¹⁸ Neni 19 i Konventës për të Drejtat e Fëmijës garanton të drejtën e çdo fëmije për të jetuar i lirë nga dhuna. Konventa merrret edhe me të drejtat e fëmijës (jo të drejtat e prindit) për të ruajtur kontaktin me të dy prindërit në se kjo nuk bie ndesh me interesat më të mira të fëmijës.

¹⁹ Neni 31, Konventa e Stambollit.

²⁰ Shih, për shembull, Nenin 6, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara; dhe Rekomandimet e Përgjithshme të Komitetit CEDAW Nr. 19 dhe Nr. 35.

²¹ Aktet e dhunës, shfrytëzimit dhe/ose abuzimit ndaj grave me aftësi të kufizuara mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në, forcën fizike; shtrëngimin ekonomik; trafikimin; mashtrimin; dezinformatën; braktisjen; mungesën e pëlqimit të lirë dhe të informuar dhe detyrimit ligjor; lënien pas dore, përfshi ndalimin ose refuzimin e qasjes në mjekim, heqjen ose kontrollimin e mjeteve ndihmëse të komunikimit ose refuzimin e ndihmës për të komunikuar, mohimin e lëvizshmërisë personale dhe aksesueshmërisë, si heqja ose shkatërrimi i formave të aksesit si p.sh. rampat, ose pajisjet

ndihmëse si shkopi për të verbrit ose pajisje lëvizëse si p.sh. karrige me rrota; refuzimi nga ana e kujdestarëve për të ndihmuar në jetën e përditshme si larja, ndihma gjatë menstruacioneve ose për higjienën personale, veshjen dhe ushqimin, duke mohuar kështu të drejtën për të jetuar në mënyrë të pavarur dhe të lirë pa trajtim degradues; mohimin e ushqimit ose ujit, ose kërcënimi me ndonjë prej këtyre akteve; ngacmimi, abuzimi verbal dhe tallja për shkak të aftësisë së kufizuar duke shkakuar frikë me anë të frikësimit; dëmtimi ose kërcënimi për dëmtim; heqja ose vrasja e kafshëve shtëpiake ose qenve ndihmës ose shkatërrimi i objekteve; manipulim psikologjik; kontrolli i sjelljeve që përfshijnë kufizimin e takimit personalisht ose virtualisht me familjen, miqtë ose të tjerë; shtatzënia ose sterilizimi i detyruar, i shtrëngua ose ndryshe i pavullnetshëm. Dhuna seksuale ndaj grave me aftësi të kufizuara përfshin përdhunimin. Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Komenti i Përgjithshëm Nr. 3 (2016), Neni 6: Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, 2 shtator 2016, CRPD/C/GC/3. Gjetet në <https://www.refworld.org/docid/57c977344.html> (aksesuar më 17 janar 2022).

→ TRAJNUES TË SPECIALIZUAR DHE TË PËRKUSHTUAR

Përveç kriterëve të përgjithshme për përzgjedhjen e trajnuesve në institucionet e trajnimit, **të gjithë trajnuesit e DHNGV-së duhet të kenë njohuri të specializuara për DHNGV-në.** Për shembull, kualifikimet për trajnuesit e DHNGV-së mund të përfshijnë kërkesat për edukimin për DHNGV-në përfshi DHF-në, me fokus në zbatimin e ligjit dhe sistemin e drejtësisë; një minimum prej pesë vitesh përvojë në kryerjen e trajnimeve të DHNGV-së me organet e zbatimit të ligjit dhe gjyqësorin; përvojë në trajtimin e paragjyqimeve dhe stereotipive gjinore; kapacitete të specializuara siç janë aftësitë e intervistimit të fokusuar te viktimat; dhe njohuri të provuara dhe të specializuara për temat përkatëse, si p.sh. reagimi i shumë sektorëve. Është gjithashtu

e rëndësishme të angazhohen profesionistët që ofrojnë shërbime të specializuara mbështetëse për viktimat, në mënyrë që ata të mund të prezantojnë përvojat dhe nevojat e viktimave në kursin e trajnimit.

Qëndrimet personale të trajnuesve dhe përkushtimi ndaj tolerancës zero për DHNGV-në, janë veçanërisht të rëndësishme. Ngritja e ekipeve të trajnuesve me seks të përzier mund të jetë efektive për të forcuar më tej nocionin se DHNGV-ja nuk është ekskluzivisht një çështje e grave, por se duhet të angazhohen edhe burrat. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet metodave të mësimdhënies për trajnuesit për të përballuar rezistencën dhe seksizmin e mundshëm midis pjesëmarrësve në trajnim.

→ METODAT NDËRVEPRUESE DHE TRANSFORMUESE TË TRAJNIMIT

Trajnimi për DHNGV-në duhet të zbatohet metoda transformuese gjinore që synojnë të **sfidojnë stereotipitë gjinore dhe paragjykimet e brendshme** me të cilat mund të pajtohen profesionistët e sektorit të policisë dhe drejtësisë. Duhet të respektohen parimet e mësimdhënies për të rriturit. Në veçanti, aktivitetet mësimore duhet t'u përshtaten motiveve dhe interesave të brendshme të pjesëmarrësve. Teknikat reflektuese të mësimdhënies duhet të përdoren për të ndihmuar pjesëmarrësit të zbulojnë dhe të vënë në pikëpyetje paragjykimet e tyre të pavetëdijshme. Trajnimi duhet të ndërtohet mbi njohuritë e mëparshme të pjesëmarrësve të cilët duhen vlerësuar si bashkëpunëtorë. Është gjithashtu e rëndësishme të krijohet një mjedis mësimor bashkëpunues në të cilin pjesëmarrësit të gjejnë një hapësirë të sigurt për të shkëmbyer idetë dhe informacionin. Është e dobishme të përdoren aktivitete në grupe të vogla ku pjesëmarrësit të kenë mundësi të krijojnë, të bisedojnë, të dëgjojnë, të shohin dhe të diskutojnë. Kjo mund të arrihet duke zbatuar rregullin 70–30 sipas të cilit pjesëmarrësit flasin, shohin dhe krijojnë rreth 70 për qind të kohës, ndërsa trajneri flet për rreth 30 për qind të kohës. Një sërë materiale dhe ushtrimesh mund të

mbështesin qasje ndërvepruese, të tilla si materiale nga proceset gjyqësore hipotetike ose reale me dyer të hapura (përfshirë video ose transkriptime të dëshmimeve të viktimave), fletëpalosje, prezantime në PowerPoint, inskenime, ushtrime për të praktikuar seancat gjyqësore, ose lloje të tjera ushtrimesh të bazuara në simulim. Duke pasur parasysh kompleksitetin e trajnimit për DHNGV-në, organizimi i trajnimeve të tilla në disa seanca, mund të jetë me dobi.

Kurdoherë që është e mundur, **organizimi i trajnimeve brenda mjediseve të policisë ose gjyqësorit mund të jetë shumë efektiv për profesionistët, të cilët mund të mësojnë duke vepruar** dhe të zotërojnë qasjet e reja që do të mësojnë. Për shembull, rekomandohet që policia të kryejë trajnime për vlerësimin e rrezikut në dhoma ku viktimat të ndihen të qeta, aty ku është e mundur. Po kështu, mund të organizohen seanca trajnimi në gjykatë për gjyqtarët dhe prokurorët duke përdorur studime praktike të rasteve të deklaratave ose dëshmimeve të viktimave (me kusht që deklarata të tilla të jenë dhënë gjatë seancave dëgjimore me dyer të hapura ose të jenë anonime).

→ FINANCIMI

Reagimi efektiv për dhunën ndaj grave mund të arrihet, inter alia (ndër të tjera), nëpërmjet trajnimit të duhur²². Për të përmbushur detyrimin e prezantimit dhe zbatimit të trajnimit të duhur për DHNGV-në, Shtetet Palë duhet të caktojnë fonde të mjaftueshme rregullisht dhe në kohën e duhur. Zbatimi i qëndrueshëm dhe sistematik i trajnimit për DHNGV-në mund të mbështetet, pjesërisht, nga organizata

ndërkombëtare ose kombëtare, por ai duhet të kryhet nën udhëheqjen dhe në bashkëpunim të ngushtë me institucionet përkatëse dhe të certifikuara për trajnimin profesional. Ndërsa bashkëpunimi me organizata të tjera mund të përmirësojë trajnimin, megjithatë është detyrim i Shteteve Palë të sigurojnë që trajnimi për DHNGV-në të financohet në mënyrë të mjaftueshme dhe të vazhdueshme.

→ MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Nevoja për vlerësimin është e dyfishtë. **Monitorimi dhe vlerësimi i rregullt dhe i institucionalizuar** i njohurive të fituara nëpërmjet trajnimit është një prioritet si për trajnimin bazë ashtu dhe atë gjatë punës²³. Ai mund të zbatohet duke përdorur pyetësorët e standardizuar të monitorimit dhe vlerësimit si dhe testet para dhe pas trajnimit, ushtrimet e vlerësimit ose metoda të tjera që shërbejnë për të vlerësuar dhe matur nivelet e dijeve të pjesëmarrësve përpara dhe pas trajnimit si dhe njohuritë dhe aftësitë e reja të përftuara.

Për më tepër, duhet të vendosen një sërë treguesish për të matur ndikimin e trajnimit në sjelljen profesionale

që rrit sigurinë e viktimave dhe besimin e tyre në institucionet e drejtësisë. Vlerësime të tilla duhet të kryhen periodikisht dhe në intervale të rregullta (për shembull, çdo katër vjet) nga vlerësuesit e jashtëm, të cilët duhet të jenë të certifikuar dhe të kenë aftësitë e nevojshme për të kryer vlerësime të çështjeve që kanë të bëjnë me DHNGV-në. Vlerësimet duhet të kryhen për fusha të tilla si efektiviteti i metodave të përdorura dhe ndikimi i trajnimit në përmirësimin e efektivitetit të reagimit të të trajnuarve ndaj DHNGV-së.

Monitorimi dhe vlerësimi i rregullt (M&V) ofron gjithashtu bazën faktike për përditësimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimit në të ardhmen.

²² Neni 8, Konventa e Stambollit.

²³ Neni 6, Konventa e Stambollit.

TABELA:

Masat dhe rekomandimet për kurrikulat e trajnimit për DHNGV-në për policinë dhe gjyqësorin në rajonin e Evropës Juglindore

STANDARDET MINIMALE BAZË	BURIMI I STANDARDEVE NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE	KONTEKSTI DHE SFIDAT RAJONALE	MASAT DHE REKOMANDIMET PËR RAJONIN E EVROPËS JUGLINDORE
<p>→ STANDARDI I KUJDESIT TË DUHUR</p>	<p>Neni 5, Konventa e Stambollit</p>	<p>Jo të gjitha Shtetet Palë kanë përfshirë parimin e kujdesit të duhur në legjislacionin e tyre përkatës.</p> <hr/> <p>Shtetet Palë në rajon nuk e kanë përfshirë parimin e kujdesit të duhur në trajnimin e DHF-së ose DHNGV-së që është organizuar deri më tani.</p>	<p>Ndryshoni legjislacionin për të përfshirë parimin e kujdesit të duhur.</p> <hr/> <p>Trajnimi si për zbatimin e ligjit ashtu edhe për gjyqësorin duhet të shtjellojë parimin e kujdesit të duhur.</p>
<p>→ INSTITUCIONALIZIMI</p>	<p>Neni 15, Konventa e Stambollit</p> <p>Rekomandimi i Përgjithshëm i Komitetit CEDAW Nr. 19, 33 dhe 35</p>	<p>Dispozitat ligjore për DHF-në kanë kryesisht një qasje neutrale ndaj gjinisë.</p> <p>Shtetet Palë kanë ligje neutrale ndaj gjinisë kundër diskriminimit ose ligje për trajtimin e barabartë.</p> <hr/> <p>Trajnimi për DHNGV-në nuk është i institucionalizuar apo i sistemuar as për policinë dhe as për gjyqësorin.</p>	<p>Hartoni legjislacion të ndjeshëm ndaj gjinisë.</p> <hr/> <p>Vendosni detyrime ligjore për trajnime të standardizuara dhe të rregullta për DHNGV/DHF-në.</p> <p>Miratoni kërkesa të standardizuara për trajnimin e licencuar për DHNGV/DHF-në si për policinë ashtu edhe për sektorin gjyqësor.</p> <p>Miratoni programe të standardizuara për ndërtimin e kapaciteteve me certifikimin e përshtatëm për policinë dhe gjyqësorin.</p>

→ **KONTEKSTUALIZIMI**

Neni 3, Konventa e Stambollit

DHNGV-ja ende nuk njihet si një formë e DHBGJ-së ose si diskriminim me bazë seksi/gjinie.

Kontekstualizoni trajnimin për DHNGV-në sipas kontekstit social dhe përpiquni të kuptoni se DHNGV-ja kushtëzohet nga vlerat kulturore, tradicionale, pronësore, politike dhe morale.

Trajnimi përgjithësisht nuk përshtatet me specifikat e secilit kontekst dhe as nuk trajton modelet, paragjykimet apo stereotipitë lokale, sociale dhe kulturore.

Organizoni trajnimet e duhura dhe hartoni politikat e duhura institucionale që synojnë zhdukjen e paragjykimeve dhe stereotipive gjinore.

Trajtoni stereotipitë, paragjykimet dhe anshmëritë që paraqesin sfida për zbatimin e reagimeve të ndjeshme gjinore ndaj dhunës kundër grave.

→ **VLERËSIMI I NEVOJAVE**

Nenet 10 dhe 11, Konventa e Stambollit

Ka mungesë të një vlerësimi të strukturuar, të rregullt/periodik, të bazuar në njohuritë e programeve të rritjes së kapaciteteve të DHNGV/DHF-së në Shtetet Palë në rajon.n.

Të bëhen rregullisht vlerësimet e nevojave si një aktivitet për të shoqëruar trajnimin.

Bëni vlerësimet e qëndrimeve dhe perceptimeve ndaj barazisë gjinore, roleve gjinore dhe stereotipive gjinore, si dhe nevojave për njohuri dhe aftësi të pjesëmarrësve potencialë në trajnim si dhe njohurive të tyre të mëparshme gjinore.

Vlerësoni nevojat e popullatës së synuar në lidhje me mbështetjen e kërkuar nga profesionistët përkatës.

Vlerësoni se si institucionet e tjera të përfshira në parandalimin dhe mbrojtjen e shohin funksionimin e institucioneve të zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit në drejtim të mbrojtjes dhe mbështetjes së viktimave.

→ **PROGRAMI DHE
MATERIALET
E VEÇANTA TË
TRAJNIMIT PËR
DHNGV-NË**

**Neni 15, Konventa
e Stambollit**

**Rekomandimi i
Përgjithshëm i
Komitetit CEDAW
Nr. 19, 33 dhe 35**

**GREVIO
Rekomandimi i
Përgjithshëm Nr.
1 për dimensionin
digjital të dhunës
ndaj grave**

Ka mungesë trajnimi për të gjitha format e DHNGV-së dhe për shkaqet dhe pasojat e saj, përfshi mungesën e trajnimit sistematik dhe të standardizuar shumë-sektorial bazë dhe gjatë punës për profesionistët e policisë dhe gjyqësorit në rajon.

Hartoni dhe prezantoni një program të veçantë trajnimi për DHNGV-në, për të trajtuar të gjitha format e DHNGV-së, duke nënvizuar dinamikën e fuqisë gjinore si një motiv parësor për DHNGV-në.

Hartoni kurrikula për trajnimin që përditësohen rregullisht dhe që pasqyrojnë standardet ndërkombëtare dhe kontekstin vendas (ligjor dhe social/kulturor).

Hartoni manuale trajnimi për DHNGV-në.

Hartoni trajnime dhe module trajnimi mbi dimensionet digjitale të DHNGV-së.

Hartoni trajnime që nënvizojnë ndërlidhjen e barazisë gjinore dhe DHNGV-së.

Përfshini module dhe zhvilloni mjete për forcimin e sigurisë së viktimave dhe kryerjen e vlerësimeve të rrezikut.

Vendosni bashkërendimin midis shumë sektorëve si dhe një sërë masash për të forcuar bashkërendimin (përfshirë përmes trajnimeve të përbashkëta, protokolleve dhe procedurave standarde vepruese).

→ **TRAJNIME DHNGV
TË DETYRUESHME
DHE SISTEMATIKE**

**Neni 15, Konventa
e Stambollit**

Të gjitha Shtetet Palë të përfshira në hartëzim kanë caktuar institucionet përgjegjëse për kryerjen e trajnimit bazë (fillestar) dhe gjatë punës (të vazhdueshëm).

Zhvilloni dhe organizoni trajnime për të trajtuar të gjitha format e DHNGV-së.

Ka mungesë të trajnimit sistematik dhe të standardizuar fillestar dhe gjatë punës për profesionistët e policisë dhe drejtësisë të shumë sektorëve.

Zhvilloni trajnimin fillestar dhe gjatë punës të standardizuar dhe sistematik në shumë sektorë.

Trajnimi fillestar përfshin DHF-në brenda moduleve të ndryshme, por në programet e trajnimit mungon një kuptim gjinor i fenomenit të DHNGV-së.

Zhvilloni trajnimin fillestar për DHF-në që trajton natyrën gjinore të kësaj forme specifike të DHNGV-së.

Trajnimi për DHNGV-në duhet të jetë gjithashtu i disponueshëm për profesionistët që marrin pjesë në proceset gjyqësore dhe japin opinione ekspertësh.

→ **BARAZIA GJINORE
DHE DHUNA NË
BAZË GJINORE
NDAJ GRAVE DHE
VAJZAVE**

**Neni 3, Konventa e
Stambollit**

**Rekomandimi i
Përgjithshëm i
Komitetit CEDAW
Nr. 19 dhe 35**

Trajnimi për DHGVN-në në rajon organizohet në baza ad hoc dhe nuk është standardizuar përmes institucioneve trajnuese.

Zhvilloni trajnime të përshtatshme që do të sfidojnë qëndrimet paragjyqëse dhe do të eliminojnë stereotipitë jo vetëm në nivel individësh por edhe në nivel institucionesh.

Trajnimi për DHF-në në Shtetet Palë të rajonit organizohet si trajnim fillestar, por pa kuptimin gjinor të fenomenit, përfshi kuptimin e marrëdhënieve të pushtetit midis burrave dhe grave.

Materialet e trajnimit duhet të paraqesin natyrën gjinore të DHNGV-së dhe se si dhuna me bazë gjinore buron nga pabarazia dhe e përjetëson atë.

→ **QASJA ME BAZË
GJINORE NDAJ TË
GJITHA FORMAVE
TË DHUNËS NDAJ
GRAVE DHE
VAJZAVE, PËRFSHI
DHUNËN NË
FAMILJE**

**Neni 3, Konventa
e Stambollit**

Trajnimi fillestar për policinë dhe gjyqësorin përfshin DHF-në brenda moduleve të ndryshme, por mungon një kuptim gjinor i fenomenit të DHNGV-së në programet e trajnimit.

Prezantoni trajnime që trajtojnë të gjitha format e dhunës ndaj grave. Sigurohuni që trajnimi për DHF-në e trajton çështjen në të gjitha format e saj (që mund të përfshijë dhunën fizike, seksuale, psikologjike dhe ekonomike). Përveç kësaj, DHF-ja duhet të paraqitet si një formë e dhunës që prek në mënyrë disproporcionale gratë dhe për këtë arsye është gjinore.

Prezantoni trajnime sipas qasjes të bazuar në të drejtat që synon të integrojë parandalimin e DHNGV-së mbrojtjen e viktimave dhe ndjekjen penale të autorëve.

→ **QASJA ME
QENDËR
VIKTIMËN**

**Nenet 4, 12 dhe
18, Konventa e
Stambollit**

**Rekomandimi i
Përgjithshëm i
Komitetit CEDAW
Nr. 35 mbi gratë e
pakicave**

Në rajon, programet e trajnimit si për policinë ashtu dhe gjyqësorin kanë mungesa në qasjen me qendër viktimën që promovon respekt dhe barazi për gratë dhe vajzat, të cilat kanë vuajtur dhunën, duke ofruar mjete praktike për sigurinë dhe fuqizimin e tyre.

Trajnimi duhet të përfshijë udhëzime të qarta si të kuptohen nevojat e viktimave dhe si të trajtohen ato me respekt dhe ndjeshmëri, përfshi fuqizimin e tyre për të marrë vendime të informuara që reflektojnë më së miri interesat e tyre.

Trajnimi duhet të kontribuojë në një qëndrim jo diskriminues dhe për të kuptuar se disa rrethana mund t'i bëjnë viktimat të caktuara veçanërisht të cenueshme. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mënyrës se si ndërthuren faktorët që rrisin cenueshmërinë.

Trajnimi duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë eliminimit të fajësimit të viktimave dhe qëndrimeve që i bëjnë viktimat përgjegjëse për aktet e dhunës.

→ **QASJA E
KOORDINUAR
E AGJENCIVE TË
SHUMTA**

**Nenet 7, 15 dhe
18, Konventa e
Stambollit**

Jo të gjitha Shtetet Palë në rajon kanë zhvilluar një protokoll për bashkëpunimin e shumë sektorëve ose procedura standarde veprimi për rastet e DHNGV/DHF-së.

Krijoni një sistem për bashkërendimin midis shumë sektorëve për DHNGV/DHF-në.

Organizimi rregullisht i trajnimeve për bashkëpunimin midis shumë sektorëve dhe referimet është ende një sfidë për shumicën e Shteteve Palë.

Organizoni trajnime të rregullta të detyrueshme mbi bashkëpunimin midis shumë sektorëve për punonjësit përkatës në sistem.

Theksoni rolin e OSHC-ve të grave në ofrimin e shërbimeve për viktimat gjatë aktiviteteve të trajnimit, në mënyrë që profesionistët e policisë dhe gjyqësorit të jenë të aftë të japin referimet e duhura për viktimat.

→ **EFEKTI I
DHUNËS MBI
FËMIJËT SI
VIKTIMA DHE
DËSHMITARË**

**Neni 31, Konventa
e Stambollit**

**Rekomandimi i
Përgjithshëm i
Komitetit CEDAW
Nr. 35**

**Neni 19, Konventa
për të Drejtat e
Fëmijës**

Trajnimi në rajon mbi temën e DHNGV-së ose DHF-së në përgjithësi nuk mbulon çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët viktima ose dëshmitarë apo nevojën për qasje të veçanta për mbrojtjen e fëmijëve në këto raste.

Trajnimi duhet të përfshijë një modul të veçantë mbi teknikat e intervistimit dhe se si të dallohen shenjat e traumës dhe të shmanget viktimizimi dytësor i fëmijëve viktima ose dëshmitarë të DHNGV-së.

Nevojitet një trajnim i veçantë për përcaktimin e të drejtave të kujdestarisë dhe vizitës së fëmijëve, gjatë të cilat do të trajtohen incidentet e DHNGV-së dhe sigurimi i ushtrimit të të drejtave të vizitës dhe kujdestarisë në mënyrë të tillë që të mos rrezikohen të drejtat dhe siguria e viktimës ose fëmijëve.

→ **QASJA E PËRFSHIRJES SË AFTËSIVE TË KUFIZUARA**

Neni 6, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara; Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) për barazinë dhe mos diskriminimin, Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Rekomandimet e Përgjithshme të Komitetit CEDAW Nr. 18 (për gratë me aftësi të kufizuara), 19 dhe 35.

Në rajon ka mungesë të trajnimeve të përshtatshme për DHNGV-në dhe DHF-në që të rrisin kapacitetet e profesionistëve të sektorit të gjyqësorit për të siguruar që çështjet e aftësive të kufizuara të merren parasysh duke mbrojtur viktimat me aftësi të kufizuara që kanë përjetuar DHNGV-në.

Zhvilloni trajnime të specializuara që trajtojnë forma të ndryshme të aftësive të kufizuara për të siguruar që viktimat e DHNGV-së dhe DHF-së të kenë qasje në drejtësi.

Trajnimi duhet të fokusohet në zhvillimin e aftësive dhe përvijën praktike dhe të mos kufizohet vetëm në konceptet e përfshirjes së aftësive të kufizuara.

Gjatë trajnimeve për DHNGV-në dhe DHF-në, trajnuesit duhet të ftojnë specialistë me aftësi të kufizuara ose që kanë njohuri të thella në aftësitë e kufizuara dhe DHNGV-në.

→ **TRAJNUES TË SPECIALIZUAR DHE TË PËRKUSHTUAR**

Neni 15, Konventa e Stambollit

Nuk ka një grup të trajnuesve të specializuar të DHNGV-së në rajon, megjithëse ka iniciativa për trajnimin e trajnuesve për tema të caktuara, kryesisht për dhunën në familje.

Të gjithë trajnuesit e DHNGV-së duhet të kenë njohuri të specializuara për DHNGV-në.

Trajnuesit e DHNGV-së duhet të angazhohen personalisht për tolerancë zero ndaj DHNGV-së.

Vendosni kritere të qarta dhe të përcaktuara ligjrisht për përzgjedhjen dhe certifikimin e trajnuesve.

Përfshini profesionistë që ofrojnë shërbime të specializuara mbështetëse për gratë viktime që mund të ndajnë përvojat e viktimave me të trajnuarit.

→ **METODAT INDERAKTIVE DHE TRANSFORMUESE TË TRAJNIMIT**

Neni 15, Konventa e Stambollit

Në rajon nuk ka asnjë rregullore për shpërndarjen e sugjeruar të pjesëve interaktive dhe teorike që do të përdoren në zhvillimin dhe dhënien e trajnimeve.

Vendosni kritere të qarta duke zbatuar parimet e mësimdhënies për të rriturit në të gjitha trajnimet e DHNGV-së, përfshi përcaktimin e drejtpeshimit midis mësimi teorik dhe praktik.

Përfshini metoda transformuese gjinore që synojnë të sfidojnë stereotipat gjinore dhe paragjykimet e brendshme në të gjitha trajnimet e DHNGV-së.

→ **FINANCIMI**

Neni 8, Konventa e Stambollit

Proceset e trajnimit për policinë dhe gjyqësorin financohen kryesisht nga buxheti i institucioneve përkatëse të trajnimit, me trajnime të fokusuara pothuajse ekskluzivisht në DHF-në.

Siguroni financim të qëndrueshëm për trajnimin për DHNGV/DHF-në.

Trajnimi për DHNGV/DHF-në tradicionalisht është organizuar dhe financuar nga OSHC-të për të drejtat e grave dhe donatorë ndërkombëtarë.

Siguroni financim të qëndrueshëm për të monitoruar dhe vlerësuar cilësinë e trajnimit. Gjithashtu, investoni në auditimet e jashtme të pavarura të trajnimit.

→ **MONITORIMI DHE VLERËSIMI**

Neni 6 dhe 15, Konventa e Stambollit

Asnjë nga Shtetet Palë në rajon nuk ka krijuar M&V të rregullt dhe të institucionalizuar të njohurive të fituara nëpërmjet trajnimit bazë dhe gjatë punës.


Zhvilloni mbledhjen e standardizuar të të dhënave për trajnimin bazë, gjatë punës dhe atë në shumë sektorë.

Organizoni M&V të rregullta dhe të standardizuara të të gjithë trajnimeve bazë dhe gjatë punës për DHNGV/DHF-në.

Përdorni një metodologji të unifikuar të M&V për të ndjekur tendencat dhe ndryshimet e sjelljes midis profesionistëve që kanë marrë pjesë në trajnim.

Organizoni vlerësime të pavarura, të jashtme në intervale të paracaktuara.

Ova publikacija je deo projekta „WIN - Žene i muškarci: inovacije i umrežavanje u interesu rodne ravnopravnosti“ Sekretarijata OEBS-a. „WIN“ projekat se sprovodi uz podršku sledećih donatora:



Sekretarijat OEBS-a

Kancelarija generalnog sekretara
Program za rodna pitanja
Wallnerstrasse 6
1010 Beč-Wien, Austrija

E-pošta: equality@osce.org
www.osce.org/secretariat/gender



Sadržaj ove publikacije predstavlja stanovišta, saznanja, shvatanja i zaključke autorki i autora publikacije i ne odražava nužno poglede ili zvaničan stav Organizacije za evropsku bezbednost i saradnju (OEBS), njenih donatora i/ili zemalja učesnica. Iako je ova publikacija pripremljena uz najveću moguću pažnju, OEBS ne preuzima nikakvu odgovornost za tačnost ili potpunost informacija, instrukcija ili saveta datih u ovom dokumentu, kao ni za štamparske greške.

Nazivi koji se koriste u ovoj publikaciji i materijali koji se u njoj predstavljaju ne predstavljaju stav ili izjavu OEBS-a u vezi za pravnim statusom neke zemlje, regiona, grada ili oblasti, ili tamošnjih organa vlasti, kao ni bilo kakav pokušaj određivanja graničnih linija i/ili granica.